## KUSH JEMI NE

EULEX Kosova ka filluar punën në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje. Misioni i tij është që t'i mbështesë institucionet përkatëse të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikat më të mira evropiane.

## ÇFARË BËJMË NE

EULEX-i e përmbush mandatin e tij përmes Shtyllës për Monitorim dhe Shtyllës Operative. Misioni është i dedikuar ndaj përfshirjes së standardeve të drejtave të njeriut dhe çështjeve gjinore në të gjitha aktivitetet e tij.

## Fakte të shkurta

**Shefi i Misionit:**
Lars-Gunnar Wigemark nga Suedia

14 qershor 2020 – 14 qershor 2021

≈ 450 pjesëtarë vendas dhe ndërkombëtarë

Prishtinë, Kosovë

**Baza ligjore:**

- Vendimi i Këshillit (CFSP) 2020/792
- Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i muajit shkurt 2008
- Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

**EULEX-i mbështetet nga:**

dhe

eulex.kosovo

eulexkosovo

EULEXKosovo

www.eulex-kosovo.eu

press@eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu

# Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

*Partneriteti për drejtësi*

EULEX
European Union Rule of Law Mission
Kosovo

# SHTYLLA PËR MONITORIM

EULEX-i e vlerëson funksionimin e gjyqësorit për sa i përket përputhshmërisë procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut përmes monitorimit të rasteve të përzgjedhura në tërë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale, p.sh. në nivelin e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit.

Prej 15 qershor 2018 deri më 14 qershor 2020, monitoruesit e EULEX-it për drejtësi kanë marrë pjesë në

**784** seanca gjyqësore në **214** raste penale dhe civile

përfshirë raste të profilit të lartë, raste të krimeve të luftës, raste të dhunës në baza gjinore, krime të urrejtjes, raste të korrupsionit, si dhe raste të cilat më parë i kishte trajtuar EULEX-i. Si rrjedhojë e monitorimit janë raportet me gjetjet dhe rekomandimet për autoritetet e Kosovës që synojnë përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

EULEX-i ofron mbështetje teknike për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese nga Dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

EULEX-i i mbështet angazhimet e Shërbimit Korrektues të Kosovës për ta zhvilluar një ekip profesional të drejtuesve të lartë përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit.

**15 QERSHOR 2018 — 14 QERSHOR 2020**

Pjesëtarët e Njësisë Korrektuese të EULEX-it

- kanë kryer rreth 600 vizita në terren në objektet e ndryshme korrektuese
- kanë mbajtur qindra takime me pjesëtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës në qendrën e tij për t'i mbështetur drejtuesit e tij në adresimin e çështjeve strategjike
- kanë monitoruar 60 eskorta për në spital të burgosurve të profilit të lartë

# SHTYLLA OPERATIVE

I — II — III

Njësia Policore e Specializuar e EULEX-it është reaguesi i dytë i sigurisë në Kosovë, si pjesë e mekanizmit treshtresor të reaguesve të sigurisë

kryen patrullime ditore vëzhgimi

15 qershor 2018– 14 qershor 2020
Ushtrime për kontrollimin e turmave dhe trazirave

- 7 trajnime me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in
- 2 trajnime me Policinë e Kosovës
- 37 trajnime me KFOR-in

## BASHKËPUNIMI POLICOR NDËRKOMBËTAR

EULEX-i e lehtëson shkëmbimin e informatave ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Interpolit, Europolit apo Ministrisë së Brendshme të Serbisë.

Kërkesat prej 15 qershor 2018 deri më 14 qershor 2020

Policia e Kosovës ⟷ EULEX ⟷ INTERPOL: **2340** (përmes Zyrës Ndërlidhëse me Interpolin në kuadër të UNMIK-ut)

Policia e Kosovës ⟷ EULEX ⟷ EUROPOL: **233**

Policia e Kosovës ⟷ EULEX ⟷ Ministria e Brendshme e Serbisë: **258**

EULEX-i vazhdon ta menaxhojë programin e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve

**EKSPERTËT E EULEX-it**
Punojnë me kolegët e tyre vendas në

**INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE**

për të përcaktuar fatin e personave të zhdukur

duke ofruar ekspertizë dhe këshilla

**2008 — 14 QERSHOR 2020**

KY MISION I KA KRYER:

- **653** operacione në terren për gjetjen e personave të pagjetur
- përfshirë **164** zhvarrime
- Mbetjet mortore të **456** personave janë identifikuar
- përfshirë **316** persona të pagjetur

Ky Mision i ndihmon Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me mbështetje logjistike dhe operacionale në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës